



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 227/6 Prot

Tiranë, më 26.6.2024

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.40, datë 26/6/2024

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gramsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Gramsh,

VËREJ SE:

Me urdhrin nr. 43, datë 21.03.2024 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Gramsh”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Gramsh.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 227/1, datë 21.03.2024, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Gramsh me shkresën nr. 227/2, datë 21.03.2024 “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Gramsh”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 227/4 prot., datë 22.05.2024 “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Gramsh”, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Pas kësaj, me shkresën nr. 2208/5 prot., datë 03.06.2024 (protokolluar në KMSHC me nr. 227/5 prot., datë 06.06.2024), institucioni ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës pa vërejtje, duke u shprehur dakord me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, janë vërejtur disa mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat më me hollësi janë vënë në dukje në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- Janë konstatuar 19 raste të plotësimit të pozicioneve në shërbimin civil në kundërshtim me procedurat ligjore, të parashikuara për procesin e rekrutimit.
- Janë konstatuar mangësi në procedurën dhe përmbajtjen e proceseve administrative të kryera gjatë rekrutimit, të materializuara në aktet administrative që kanë dalë në përfundim të tyre, të tilla si: a) në disa raste nuk është përcaktuar kategoria e pagës për pozicionin përkatës, në shpalljen e procedurës së konkurrimit; b) procedura e konkurrimit në disa raste, nuk është protokolluar në një numër protokolli, por në numra protokolli të ndryshëm, për shkak të dërgimit pranë AKPA-s me një shkresë të vetme, në grup të njoftimeve për shpallje të pozicioneve vakante dhe jo për çdo procedurë më vehte; c) në të gjitha procedurat e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil, deklarata e paanësisë së anëtarëve të KPP nuk është nënshkruar në formularë të veçantë nga secili anëtar i komisionit në mënyrë individuale, por në një formular të vetëm kanë nënshkruar të gjithë anëtarët; d) Komiteti i Përhershëm i Pranimit, nuk ka funksionuar i njejtë për të gjitha procedurat e kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit siç parashikon legjislacioni, por është ngritur rast pas rasti.

- Gjatë procedurës së vendimmarrjes në fund të periudhës së provës: a) në të gjitha rastet, rezulton se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe, si rezultat, mungon mendimi me shkrim i tij; b) në formularin e vlerësimit vjetor të punës, të nëpunësit civil në periudhë prove, mungojnë komentet e zyrtarit raportues, të cilat janë element i nevojshëm për të vlerësuar objektivitetin e zyrtarit në përcaktimin e nivelit të vlerësimit të rezultateve në punë gjatë kësaj periudhe; c) në aktet e vlerësimit të punës, shpesh nuk janë plotësuar në mënyrë të saktë dhe të qartë të gjitha të dhënat që kërkohen në ndarjet e formularit dhe të jenë nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e vlerësimit dhe nëpunësi i vlerësuar.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duke zbatuar me korrektësi të gjitha kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbytjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gramsh, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Me qëllim realizimin në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil,

lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të veprojë duke ndjekur këto orientime:

- ✓ Nisur nga numri i lartë i pozicioneve vakante në institucion, si dhe nisur nga numri i lartë i pozicioneve të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të riorganizohet plani i rekrutimit për vitin 2024, duke përfshirë të gjitha pozicionet e lira në kuptim të ligjit (*pozicionet që janë aktualisht të lira dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin*) dhe të publikohet plani i ndryshuar sipas kërkesave të ligjit.
 - ✓ Pozicionet e nivelit ekzekutiv të klasifikohen sipas natyrës së pozicionit, në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe në grupet e administrimit të posaçëm. Për pozicionet “*Specialist*”, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta, konkurrimet të zhvillohen në grup pozicionesh, sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 8, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
3. Kryetari i Bashkisë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit në kundërshtim me ligjin dhe të rregullojë pasojat në përputhje me nenin 111, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, për pozicionet e punës, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit të punonjësit, aktit të emërimit dhe pozicionit të punës:
1. ***** , me aktin nr. 53, datë 24.02.2022, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Specialist për koordinimin me Njësitë Administrative*” në Sektorin Juridik, IT-së dhe Monitorimit të Performancës;
 2. ***** , me aktin nr. 05.10.2022, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Arkivës dhe Protokollit*”;
 3. ***** , me aktin nr. 267, datë 10.10.2023, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Drejtor i financës dhe buxhetit*”;
 4. ***** , me aktin nr. 196, datë 28.08.2023, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori i të Ardhurave Familjare dhe Njësive Administrative*”;
 5. ***** , me aktin nr. 187, datë 08.08.2023, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”;
 6. ***** , me aktin nr. 204, datë 11.08.2023, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”;
 7. ***** , me aktin nr. 205, datë 11.08.2023, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Specialist për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”;
 8. ***** , me aktin nr. 11, datë 12.01.2023, të titullarit, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i i Emergjencave Civile dhe Strehimit*”;

9. ***** , me aktin nr. 219 datë 21.08.2023, të titullarit, emëruar në pozicionin “Specialist për turizmin” në Sektorin e Turizmit, Rinisë dhe Integritimit në BE;
10. ***** , me aktin nr. 24, datë 19.01.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Specialist i Auditimit të Brendshëm”;
11. ***** , me aktin nr. 26 datë, 19.02.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit Financiar”;
12. ***** , me aktin nr. 39, dt.01.02.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Mbrojtjes Shoqërore”;
13. ***** , me aktin nr. 45, datë 02.02.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Specialist i mbrojtjes sociale”;
14. ***** , me aktin nr. 25, datë 19.01.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori i të Ardhurave nga Biznesi dhe Transporti”;
15. ***** , me aktin nr. 29, datë 25.01.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore”;
16. ***** , me aktin nr. 34, date 31.01.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Specialist për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
17. ***** , me aktin nr. 43, date 02.02.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Drejtor i i Emergjencave Civile, Strehimit dhe Koordinimit me Njësitë Administrative”;
18. ***** , me aktin nr. 07, datë 10.01.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Drejtor Juridik dhe Burimeve Njerëzore”;
19. ***** , me aktin nr. 30 datë 29.01.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Specialist për Nj. A Kushovë” pranë Njësisë Administrative Kushovë.

Njësia përgjegjëse të shpallë menjëherë për t’u plotësuar në përputhje me ligjin pozicionet e punës si më sipër. Në momentin e shpalljes në AKPA, pozicioni i punës duhet të jetë efektivisht i lirë.

Njësia përgjegjëse, të planifikojë dhe organizojë zhvillimin e këtij procesi, duke siguruar që konstatimi i pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, mbështetur në nenet 22, 23 e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
5. Me kalimin e këtij afati subjekti i mbikëqyrur, Bashkia Gramsh, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij

vendimi, si dhe të dërgojë dokumentacionin që vërteton masat e marra për të rregulluar situatën e ligjshmërisë.

6. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Gramsh, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha